

Policia përplasat me hajnat në Malishevë, përdoren edhe armët

LAJME

LAJMI I FUNDIT

lajmi.net

Më afër lexuesit.

03/05/2023 09:06

f t l

Policia e Kosovës përmes raportit 24-të orësh ka raportuar se gjatë ditës së djeshme janë përgjigjur thirrjes për një rast vjedhje e rëndë.

Policia ka dalë në vendin e ngjarjes dhe gjatë kërkimit të personave, kanë takuar tre prej tyre, dhe pas urdhrit nga policia që të ndalojnë, njëri prej tyre në afërsi prej 15 metrash ka shtënë me armë në drejtim të policisë.

“Fsh. Mirushë, Malishevë, 02.05.2023 – 20:53. Njësitë policore janë përgjigjur thirrjes për një rast vjedhje e rëndë. Njësitë policor ka dalë në vendin e ngjarjes dhe gjatë kërkimit të personave të dyshuar kanë takuar tre persona ku pasi u është dhënë urdhri për ndalim njëri nga të dyshuarit në afërsi prej rreth 15 metra ka shtënë me armë zjarri në drejtim të zyrtarëve policorë, po ashtu edhe zyrtarët policorë i janë kundër përgjigjur duke shtënë në drejtim të tyre”

Të dyshuarit kanë arritur të largohen nga vendi i ngjarjes, dhe nuk raportohet për të lënduar.

Për rastin është njoftuar prokurori dhe vazhdon të jetë nën hetime./Lajmi.net/

Artikuj të ngjashëm



May 3, 2023

Kurti: Kriminelët e luftës duhet nxjerrur para drejtësisë, Kosova nuk mund...



May 3, 2023

Tahiri: I papranueshëm barazimi i agresorit me viktimën



May 3, 2023

Të shtënat me armë në një shkollë fillore në Beograd, është...



May 3, 2023

Haradinaj: Shqetësuese sulmet që i bëhen mediave dhe gazetarëve dhe tendenca...



May 3, 2023

Osmani: Liria e medias, shtyllë e një demokracie të lulëzuar



May 3, 2023

Arrestohen dy persona për prostitucion në Prishtinë